

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "REMANII" sh.p.k

Në Durrës, sot në datën 19/07/2021(Nëntëmbëdhjetë/ Korrik/ Dymijë e njëzetë e një), unë :

Z. Jashar Luku, atësia Sabri, amësia Hatixhe, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Pavaresia 00690611; Nd. 16; H. 1; Ap. 4; Durrës; 2008;; lindur më 23/05/1945, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, për me Leternjoftim ID nr. 035347430 dhe nr. personal E50523028K.

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i azhornuar), Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" etj.

Z. Jashar Luku themelon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar "**REMANII**" sh.p.k.

Selia e shoqërisë është Durrës, Lagja nr.13, Plazh, Zona kadastrale 8518, nr. pasurie 3/121+1-2,

Objekti i shoqërisë është: Zbatimi i punimeve te ndertimit, germime dheu, prodhim materiale inerte-gure, prodhim elemente betoni, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, ndertime rruge, ura, vepra arti, ujesjellesa, kanalizime, kanale e impiante vaditese, punime karpentiere druri, metalike, pastrim i siperfaqes urbane, projektim objektsh civile, industriale, turistike, prodhim e tregtim i materiale te ndertimit.

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është **pa afat**.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1'000 (Një mijë) Lekë, i përbërë nga **1 kuotë** me vlerë nominale 1'000 Lekë dhe zotërohet nga ortaku themelues z. Jashar Luku.

Shoqëria do të shtrijë aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë. Me Vendim të Asamblesë së përgjithshme mund të ndryshohet, krijohen ose anulohen në rast se janë çelur, Seli, Filiale, Agjenci dhe perfaqësi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë.

Administrimi i shoqërisë

Administrator i shoqërisë emërohet z. Jashar Luku. i datëlindjes 23/05/1945, lindur në Durrës, me nr. personal E50523028K, i cili deklaron se pranon rolin e ngarkuar dhe se nuk ëgzistojnë shkaqe të ligjshme që mund ta shpallin të pavlefshme.

Afati i emërimit të administratorit është pesë vjet. Administratori emërohet sot në datën 19/07/2021 dhe përfundon në datën 19/07/2026. Emërimi i prodhon efektet pas regjistrimit ne Qendrën Kombetare të Regjistrimit (Neni 95, pika e parë e Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 "Per tregaret dhe shoqerite tregtare")

Administratori përfaqëson shoqërinë tregtare, kryen veprimtarinë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politika tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.

Në rastet e kryerjes së veprimtarive të rëndësishme që kanë të bëjnë me shpenzime në vlera të mëdha dhe që lidhen me transkaksione të pasurive të paluajtshme, shkëmbime apo çdo lloj tjetërsimi të tyre, zmadhime të kapitalit themeltar, venie garancie hipotekore apo bankare, marrje kredie, marrje pjesë në tendera brenda vendit apo ndërkombetare, Administratori i Përgjithshëm i emëruar kryen veprime bankare vetëm mbi bazën e Vendimit me shkrim të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, i cili duhet të jetë legalizuar nga Noteri.


Pjesët e kapitalit themelor janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie ligjore ose testamentare sipas dispozitave të Kodit Civil. Ortaku gëzon të drejtën e shitjes se kuotave jashtë



ortakërisë mbi bazen e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas procedurave që janë përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

Ky Akt Themelimi redaktohet në pesë njësi origjinale, me nga dy faqe secila, me përmbajtje e vlera të njëjta juridike dhe pasi lexohet me zë miratohet nga ortakët themelues dhe nënshkruhet prej tyre në çdo faqe.

ORTAKU THEMELUES


(Jashar Luku)